



*Prishtinë, 20 prill 2018*

## **Komunikatë për media**

### **Miratohet nga Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik Raporti Vjetor i Punës së ZRRE për vitin 2017**

Sot Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka paraqitur para Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Raportin Vjetor të Punës për vitin 2017, i cili pas prezantimit dhe pyetjeve që janë shtuar është aprovuar nga deputetët.

Siç ka theksuar në fjalën e tij, u.d së Kryesuesit të Bordit të ZRRE, Raporti Vjetor për vitin 2017 është gjithëpërfshirës dhe përveç që përshkruan zhvillimin e aktiviteteve dhe të arriturat e ZRRE-së në kuadër të fushëveprimit të saj po ashtu përmban analiza mbi zhvillimet dhe aktivitetet e përgjithshme në sektorin e energjisë në vend. Bordi i ZRRE gjatë vitit 2017 (deri më 15 maj sa ishte funksional) ka mbajtur 7 mbledhje, në të cilat ka nxjerrë një numër vendimesh, miratuar metodologji dhe procedura që rregullojnë sektorin e energjisë, aprovuar rregulla të reja dhe janë harmonizuar rregulla ekzistuese me Pakon e re Ligjore të sektorit të energjisë.

Siç është raportuar, bazuar në kornizën e re legislative dhe në bazë të detyrimet që dalin nga Pakoja e III-të e legjislacionit të BE-së për energji, në janar të vitit 2017, ZRRE ka nxjerrë “Udhëzuesin për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë”. Udhëzuesi, duke u përshtatur me rrethanat e sektorit të energjisë në vend, ka paraparë që hapja e tregut të filloj nga furnizimi me shumicë duke liberalizuar fillimisht gjenerimin dhe pastaj të vazhdohet gradualisht edhe me liberalizimin e tregut me pakicë. Sa i përket furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike me pakicë, ZRRE në vitin 2017 ka licencuar edhe dy operator të rinj, por përveç KESCO-s, dy furnizuesit tjerë ende nuk janë aktiv në treg çka e bëjnë të vështirë procesin e hapjes së mëtjshëm të tregut të energjisë. Përderisa një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve posedojnë licenca për tregtim me energji elektrike dhe licenca për prodhim, transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike dhe termike. ZRRE-së gjatë vitit 2017 ka bërë përshtatjen vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të të licencuarve që ushtrojnë veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal, si dhe të licencuarve në sektorin e energjisë termike.

Po ashtu Raporti paraqet ndryshimin e Strukturës Tarifore të energjisë elektrike me pakicë, të cilën ZRRE e ka aprovuar për të hyrë në fuqi nga data 1 prill 2017. Ndryshim esencial i kësaj Struktura është largimi i tarifave sezonale (verë/dimër) që do të përfshijnë të gjithë konsumatorët fundor, si dhe largimi i bllok tarifave për konsumatorët familjar. Z. Janova, ka vlerësuar se marrë në përgjithësi viti 2017 për ZRRE-në ka qenë mjaft sfidues për arsye se Bordi që nga 16 maj 2017 deri më 15 Mars të vitit 2018 nuk ka mundur të marr vendime për shkak se ka qenë jo funksional në mungesë të kuorumit. Si dhe sfidë tjetër është vendimi i Gjykatës, për masën e përkohshme lidhur me faturimin



në pjesën veriore të Kosovës, dhe ndikimi i tij në Sektorin e Energjisë deri në zgjidhjen afatgjate të këtij problemi.

Deputetët, duke vlerësuar përkushtimin e ZRRE në punën e saj dhe në raportimin para Komisionit Parlamentar, kanë kërkuar sqarime shtesë në lidhje me funksionimin e tregut të lirë, numrin e Autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja të energjisë, problemet me të cilat përballohen investitorët dhe ndikimin e ndërtimit të Termocentralit të ri “Kosova e Re” në tarifatat e ardhshme dhe çështje të tjera të ndërlidhura me rregullimin e sektorit të energjisë.